

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Pril
2021



Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës

A janë dhe sa të hapura mediat serbe në Kosovë

Organizatat e shoqërisë civile në komunitetin serb të Kosovës – Në mes të perceptimit dhe prezantimit

Partitë politike të serbëve të Kosovës në sistemin politik të Kosovës: Nga pluralizmi deri te monizmi

Qëndrimet e Serbëve të Kosovës mbi institucionet e sigurisë

Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Të drejtat e komuniteteve në Kosovë

Serbët e Kosovës në procesin e dialogut

Analiza e gjendjes ekonomike të komunitetit serb në Kosovë

Titulli i hulumtimit: Qasshmëria e institucioneve për qytetarët në Kosovë

Botues: KFOS

Për botuesin: Bota bardh e zi – CBS (Crno beli svet) dhe Forumi për zhvillim dhe bashkëpunim multi-etnik – FDMC (Forum za razvoj i multi-etničku saradnju)

Autori: Verka Jovanović

Gjuha origjinale në të cilën është punuar analiza është gjuha Serbe

Përkthimi në gjuhën shqipe: Xhenana Azizi

Dizajni: tedel

Shtypshkronja (Tirazhi): tedel (100)

Ky botim u realizua në kuadër të projektit OPEN të implementuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS) në bashkëpunim me organizatat Bota bardh e zi - CBS dhe Forumi për zhvillim dhe bashkëpunim multi-etnik – FDMC. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e KFOS.

Viti i botimit: 2021

PËRMBAJTJA

01.

PËRSHKRIMI I GJENDJES DHE ZBULIMI I PROBLEMIT	7
--	----------

02.

OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA E STUDIMIT	10
Objektivat	10
Metodologjia	11
Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor	11

03.

REZULTATET E HULUMTIMIT	12
Bashkëpunimi dhe komunikimi i qeverive lokale me qytetarët	12
Bashkëpunimi dhe komunikimi i institucioneve qendrore me qytetarët	13
Besimi i qytetarëve në institucione	14
Informimi i qytetarëve nga institucionet	17
Interesimi dhe gatishmëria e qytetarëve për t'iu drejtuar institucioneve	17
Informimi i qytetarëve rreth punës së institucioneve	18
Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime dhe seanca publike të Kuvendeve Komunale	19
Sjellja e institucioneve gjatë pandemisë Covid-19	21

04.

PËRFUNDIMET	24
--------------------	-----------

05.

REKOMANDIME	26
--------------------	-----------

1. Përshkrimi i gjendjes dhe zbulimi i problemit

Funksionimi i institucioneve të Kosovës është i rregulluar me Kushtetutë dhe ligje përkatëse, rregullore, udhëzime dhe vendime. Institucionet e themeluara sipas Kushtetutës së Kosovës janë: Presidenca, Kuvendi i Kosovës, Zyra e Kryeministrit, ministritë, institucionet dhe agjencitë e pavarura, institucionet e sigurisë, si dhe pushteti lokal.¹ Të gjitha këto institucione shpesh përbëhen nga departamente, zyra, komisione dhe borde të veçanta dhe, natyrisht, përfaqësues individualë që merren me çështje me rëndësi të veçantë për qytetarët.

Qëllimi dhe synimi i vetëm i të gjitha institucioneve publike është mbrojtja e interesit të përgjithshëm dhe vendosja për çështje me interes të përgjithshëm për të gjithë qytetarët, në përputhje me kompetencat e tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligje, por edhe përfshirja e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes. Kështu, presidenti përfaqëson "unitetin e popullit",² Deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit,³ Kryeministri synon të sigurojë "qeverisje të mirë dhe transparencë në shërbim të qytetarëve të Kosovës",⁴ Kur bëhet fjalë për qeveritë lokale, Kushtetuta thekson veçanërisht nevojën për qeverisje të mirë, transparencë, efikasitet

dhe efektivitet në ofrimin e shërbimeve publike. Gjithashtu, një nga qëllimet e komunës, si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, është inkurajimi dhe sigurimi i pjesëmarrjes aktive të të gjithë qytetarëve në procesin e vendimmarrjes së organeve komunale.⁵

Pastaj, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, zbatimi i së cilit në Kosovë është i garantuar me Kushtetutë, propagandon që çdo shtetas, ka të drejtë dhe mundësi që, pa kufizime të paarsyeshme të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, qoftë drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.⁶

Kështu që, të gjitha institucionet publike në Kosovë kanë një detyrim kushtetues për të përfshirë qytetarët në punën e tyre. Mënyrat e veçanta të konsultimit të qytetarëve dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje për çështje me interes të përgjithshëm përcaktohen me ligj. Qytetarët mund të përfshihen në vendimmarrje në mënyrë të pavarur ose përmes organizatave të shoqërisë civile. Përveç që mundëson që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe qytetarët të ndiejnë pronësinë mbi proceset me rëndësi publike, pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje

1 <https://www.rks-gov.net/SR/f50/republika-kosovo/lokalna-uprava>

2 <https://president-ksgov.net/sr/kan-i-nadleznosti>

3 <http://kuvendikosoves.org/srb/upoznajmo-skupstinu/uloga-i-nadleznosti-skupstine/>

4 <https://kryeministri-ks.net/sr/kancelarija-premijera/kancelarija/>

5 Kushtetuta e Kosovës (<http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Ustav1.pdf>), Qasur më: 8.9.2020.

6 <http://www.bgcentar.org.rs/bgcentar/wp-content/uploads/2013/02/Me%C4%91unarodni-pakt-ogr%C4%91anskim-i-politi%C4%8Dkim-pravima.pdf>

gjithashtu u mundëson autoriteteve që të ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë më efektive.

Ekzistojnë katër nivele të pjesëmarrjes së qytetarëve, nga ai me nivelin më të ulët të pjesëmarrjes qytetare deri në nivelin më të lartë të pjesëmarrjes.⁷ Ato janë:

- Informimi - nivel relativisht i ulët i pjesëmarrjes i cili kryesisht konsiston në sigurimin e një informacioni njëkohësh nga autoritetet publike, pa kërkuar ose prituri reagim ose përfshirje të qytetarëve; megjithatë, nëse qytetarët nuk janë informuar paraprakisht për planet dhe punën e institucioneve publike, ata nuk mund të marrin pjesë në ndonjë fazë të mëtejshme të punës së institucioneve të caktuara.
- Konsultimet - një formë e pjesëmarrjes me iniciativë të autoriteteve publike që kërkojnë opinionet, pikëpamjet ose reagimet e qytetarëve për një temë specifike;
- Dialogu - një proces i vazhdueshëm i konsultimit midis autoriteteve publike, qytetarëve dhe OShC-ve që zhvillohet në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të politikave;
- Partneriteti - forma më e lartë e pjesëmarrjes ku autoritetet publike fillojnë të bashkëpunojnë ngushtë me OShC-të, duke siguruar kontinuitetin e pavarësisë së OShC-ve.

Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrje së bashku me autoritetet, llogaridhënia e qeverisë ndaj qytetarëve për veprimet dhe vendimet e tyre dhe transparencën në punën e qeverisë, përkatësisht sigurimi i informacionit për qytetarët janë elemente të rëndësishëm të qeverisjes me pjesëmarrje për të cilën përpiqet çdo shoqëri e orientuar kah vlerat evropiane. Qytetarët duhet të marrin pjesë në çdo pikë të ciklit të politikave, përfshirë hartimin e agjendës për çështjet që do të adresohen nga komuna, formulimin e politikave, vendimarrjen, zbatimin e vendimeve, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe vendimeve të zbatuara.⁸

7 <https://www.kcsfoundation.org/sr/informacije-i-kapaciteti/cesto-postavljanje-pitanja/ucisce-gradjana-u-donosenju-odluka/>, Qasur më 10.9.2020.

8 *Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrjen komunale në veri të Kosovës / Qeverisja me pjesëmarrje në komunat në veri të Kosovës*, Nisma e Re Sociale dhe RTV MIR (2017), Mitrovica e Veriut, <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2020/08/SRB-U%C4%8De%C5%A1%C4%87e-gra%C4%91ana-u-op%C5%A1tinskomb-dono%C5%A1enju-odluka-na-severu-Kosova.pdf>

Qytetarët, gjithashtu, duhet të informohen në mënyrë adekuate dhe në kohë për të gjitha çështjet, ngjarjet dhe vendimet me rëndësi publike.

Megjithatë, kjo nuk ndodh gjithmonë në Kosovë. Le të themi që sipas analizës së Nismës së Re Sociale (NSI), shumë mekanizma të krijuar për të siguruar pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal për shkak të mjedisit politik kompleks nuk janë funksional në komunat e veriut të Kosovës.⁹

Më tej, me hulumtimin "Sa të hapura janë qeveritë lokale për qytetarët?" Rasti: ueb faqet e qeverive lokale" Bota bardh e zi (CBS) shqyrtoi se sa ueb faqet e komunave me shumicë serbe në të gjithë Kosovën plotësojnë nevojat e qytetarëve për informim të mirë. Gjetjet tregojnë se shumica e ueb faqeve zyrtare të qeverive lokale nuk përmbushin plotësisht nevojat e qytetarëve. Për shumicën e ueb faqeve, përmbajtja nuk përditësohet rregullisht dhe për një numër të caktuar të qeverive lokale ueb faqet nuk janë funksionale. Rrjedhimisht, informimi i qytetarëve përmes ueb faqeve është i pamjaftueshëm dhe jo i rregullt, dhe qytetarët nuk mund të mbështeten në këto burime të informimit.¹⁰

Për më tepër, gjetjet e një hulumtimi të realizuar nga Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC) mbi transparencën e qeverisjes lokale dhe vetëdijen e qytetarëve për të drejtën e pjesëmarrjes në vendimarrje, tregojnë se detyrimet zyrtare të qeverive lokale në organizimin e dëgjimeve publike, takimeve konsultative dhe seancave të kuvendit zakonisht respektohen. Sidoqoftë, duhet theksuar se informacioni për mbajtjen e tubimeve nuk arrin tek qytetarët. Sipas këtij hulumtimi, 62.1% e të anketuarve konsiderojnë se vendimet e qeverisë lokale nuk janë në dispozicion për publikun e gjerë, dhe rreth 70% e të

[odluka-na-severu-Kosova.pdf](#), Qasur më: 10.11.2020.

9 *Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrjen komunale në veri të Kosovës / Qeverisja me pjesëmarrje në komunat në veri të Kosovës*, Nisma e Re Sociale (2017), Mitrovica e Veriut, <http://newsocialinitiative.org/wp-content/uploads/2020/08/SRB-U%C4%8De%C5%A1%C4%87e-gra%C4%91ana-u-op%C5%A1tinskomb-dono%C5%A1enju-odluka-na-severu-Kosova.pdf>, Qasur më: 10.11.2020.

10 *Sa të hapura janë qeveritë lokale për qytetarët? Rasti: ueb faqet e qeverive lokale* Bota bardh e zi - CBS (2020), Mitrovica e Veriut <http://crnobelisvet.com/wp-content/uploads/2020/01/Koliko-su-lokalne-samoprave-otvorene-za-gra%C4%91ane-online.pdf>, Qasur më: 10.11.2020.

anketuarve nuk janë të sigurt ose nuk kanë njohuri për komisionet konsultative.¹¹

Në kuadër të hulumtimit "Transparometri Komunal për vitin 2019", është kryer matja transparencën në të gjitha 38 komunat e Kosovës,^{12,13} më së shumti pikë për transparencë nga komunat me shumicë serbe ka marrë komuna e Graçanicës (71.88 nga maksimumi prej 96) dhe më së paku Zubin Potoku (55.21) dhe Mitrovica e Veriut (40.63). Sipas këtij hulumtimi, shumica e komunave me shumicë serbe organizuan diskutime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2020-2022, përveç komunave të Graçanicës dhe Shtërpçës, të cilat nuk organizuan asnjë diskutim publik për KAB. Ndërsa Shtërpça është komuna e vetme me shumicë serbe, kuvendi komunal i së cilës nuk organizoi ndonjë diskutim publik gjatë shtatorit 2019 mbi buxhetin e vitit 2020.

Gjatë hulumtimit "Transparometri Komunal për vitin 2019", u vu re se një numër i vogël i qytetarëve marrin pjesë në diskutime publike dhe dëgjime buxhetore të organizuara nga komunat e Kosovës. Është vlerësuar që komunat me shumicë serbe publikojnë ose publikojnë pjesërisht ftesa për seancat e kuvendit. Mirëpo, materiali përcjellës me pikat e rendit të ditës zakonisht nuk publikohet, por kryesisht u shpërndahet vetëm këshilltarëve komunal. Gjithashtu, në shumicën e komunave serbe, zakonisht nuk ka transmetim të drejtpërdrejtë të seancave, as publikim të videove nga seancat e kuvendeve komunale. Pastaj, kur bëhet fjalë për konkurset e punësimeve dhe kriteret për vendet e lira të punës, shumica e komunave i kanë publikuar, ndërsa katër (4) komuna

11 "Fuqizimi i transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal në veri të Kosovës", Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike – ACDC (2019), Mitrovica e Veriut <https://acdc-kosovo.org/documents/PolicyPaperTranspKFOS2019SRB.pdf>

12 "Transparometri Komunal për vitin 2019, OJQ Aktiv dhe KDI (2020), <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Opstinski-transparometar-2019-SRB.pdf>, Qasur më; 12.11.2020.

13 Ndër treguesit e transparencës të përdorur janë: a kanë mbajtur kuvendet komunale seanca të rregullta dhe a janë të hapura për publikun, a janë publikuar njoftimet për seanca 7 ditë para mbajtjes së seancave, a i është bashkangjitur njoftimeve materiali përcjellës dhe rendi i ditës, a ka mbajtur Kuvendi Komunal diskutime publike për buxhetin vjetor për 2020, a ka qasje publiku në dokumentet e Kuvendit të Komunës, a janë konkurset dhe kriteret e punësimit të publikuara për qytetarët, a përdor Komuna rrjete sociale dhe ueb faqet në baza të rregullta për të komunikuar dhe plasuar informacione, a ka Komuna në dispozicion një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët

këto të dhëna nuk i kanë publikuar, përfshirë tri komuna me shumicë serbe - Parteshi, Zubin Potoku dhe Mitrovica e Veriut.

Prandaj, sipas hulumtimit të lartcekur, qeveritë lokale në Kosovë nuk i përdorin të gjitha metodat e parapara me ligj për informimin më të madh dhe më të mirë të qytetarëve rreth punës së tyre dhe përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Hulumtimi në vazhdim do të përpiqet të zbulojë se cilët janë segmentet e punës së komunave me shumicë serbe në të cilat qasshmëria e qytetarëve është më e vogël, dhe në cilat segmente është e nevojshme ngritja e qasshmërisë së institucioneve. Gjithashtu, do të përpiqemi të zbulojmë nga qytetarët, por edhe nga përfaqësuesit e institucioneve, se çfarë është ajo që ata duhet të bëjnë, si qytetarët ashtu edhe institucionet, në mënyrë që pjesëmarrja e qytetarëve të jetë më e lartë dhe puna e institucioneve më gjithëpërfshirëse. Së fundmi, do të përpiqemi të zbulojmë se sa institucionet qendrore, kryesisht anëtarët e Kuvendit të Kosovës, konsultohen me qytetarët në punën e tyre, si institucionet qendrore i informojnë qytetarët dhe nëse ata u përgjigjen kërkesave të qytetarëve.

Pyetja kryesore e këtij hulumtimi në të cilën do të përpiqemi të përgjigjemi është:
A janë institucionet publike në Kosovë mjaftueshëm të hapura për qytetarët?

Do t'i përgjigjemi pyetjes kryesore duke përdorur nën-pyetjet e mëposhtme:

- *Sa janë të hapura institucionet lokale dhe qendrore në Kosovë për komunikim me qytetarët?*
- *A i informojnë institucionet në mënyrë adekuate dhe në kohë qytetarët për punën e tyre? Si i informojnë?*
- *Sa i përfshijnë qeveritë lokale dhe Kuvendi i Kosovës qytetarët në vendimmarrje?*
- *Sa të hapur dhe të gatshëm janë anëtarët e komunitetit serb për t'u "mbështetur" në institucionet e Kosovës?*
- *Në cilat institucione besojnë më shumë qytetarët?*

2. Objektivat dhe metodologjia e studimit

Objektivat

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të kontribuojë në kuptim më të mirë të pozitës së komunitetit serb në Kosovë duke monitoruar se sa të hapura janë institucionet ndaj interesave dhe problemeve të tyre.

Në përputhje me qëllimin kryesor, do të përpiqemi të konkretizojmë hulumtimin duke ndjekur objektivat në vijim:

1. Të hulumtojmë se sa të hapura janë institucionet lokale dhe qendrore në Kosovë ndaj qytetarëve.

Më konkretisht, ky objektivi përfshin hulumtime mbi perceptimet e qytetarëve, përfaqësuesve të institucioneve dhe përfaqësuesve të sektorit civil, mbi qasshmërinë e qytetarëve në dhjetë qeveritë lokale me shumicë serbe në Kosovë dhe institucione qendrore, kryesisht në Kuvendin e Kosovës. Gjithashtu, hulumtimi synon të shqyrtojë gatishmërinë dhe vullnetin e institucioneve për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje.

2. Të hulumtojmë shkallën e gatishmërisë së qytetarëve serbë për t'u "mbështetur" në institucionet e Kosovës

Përmes këtij objektivi do të përpiqemi të shqyrtojmë përvojat e qytetarëve në komuna me shumicë serbe kur bëhet fjalë për pjesëmarrje, pretendim dhe ushtrim të të drejtave të tyre në institucio-

net lokale dhe qendrore të Kosovës. Pastaj do të shqyrtojmë shkallën e besimit të qytetarëve në institucione dhe përfaqësuesit e tyre në institucione. Po ashtu, do të përpiqemi të vërtetojmë nëse qytetarët ndërmarrin veprime të caktuara për të ushtruar të drejtat e tyre si dhe të vërtetojmë se cilat janë ato veprime.

3. Të shqyrtojmë nëse institucionet informojnë qytetarët në mënyrë adekuate dhe në kohë.

Ky objektivi ka për qëllim të shqyrtojë nëse institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e qytetarëve janë të hapur dhe të qasshëm për qytetarët e nacionalitetit serb kur bëhet fjalë për informim mbi çështje me interes publik. Gjithashtu, do të shqyrtojmë përgjigjet e institucioneve ndaj kërkesave të mundshme nga qytetarët për të ushtruar të drejtat e tyre dhe të hulumtojmë respektimin e detyrimeve ligjore nga institucionet për të realizuar konsultime dhe dialog me qytetarët.

4. Sjellja e institucioneve gjatë krizës Covid-19

Së fundmi, u përpoqëm që me një shembull konkret të vlerësojmë sjelljen e institucioneve gjatë pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, dhe përmes perceptimeve dhe përvojave të qytetarëve të vlerësojmë sjelljen e institucioneve gjatë periudhës së krizës.

Metodologjia

Për të arritur qëllimet e lartcekura, kemi realizuar hulumtim sasior dhe cilësor.

Metodologjia dhe modeli i hulumtimit sasior

Anketimi ballë për ballë në terren u krye në periudhën nga 1 deri më 20 tetor 2020. Gjithsej 582 qytetarë serb u anketuan në të gjithë Kosovën. 50.5% e të anketuarve janë anketuar në jug të lumit Ibër, ndërsa 49.5% e të anketuarve janë anketuar në veri të lumit Ibër. Pyetësi përbëhej nga 65 pyetje dhe përfshinte gjithsej 8 fusha. Mostra ishte e qëllimshme, me kuotë, dhe kriteri për

përcaktimin e kuotave ishte madhësia e komunës. Intervali i besimit është +/- 5. Në mostër, kishte gjithsej 54.7% meshkuj dhe 45.3% femra. Moshë mesatare e të anketuarve është 44 vjeç. Me arsim fillor ishin 14.4% të të anketuarve, 62.1% me arsim të mesme dhe 23.5% me arsim të lartë, pra fakultet. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 25.9% janë të punësuar në sektorin publik, 22.3% në sektorin privat, 35.2% janë të papunë, ndërsa 16.6% janë në pension. Është e rëndësishme të theksohet se duke pasur parasysh faktin se nuk ka statistika zyrtare mbi strukturën demografike të popullsisë së synuar, pra të popullsisë serbe në Kosovë, vetëm kushtimisht mund të flasim për përfaqësim të mostrës.

Metodologjia dhe dizajni i kërkimit cilësor

GRUPET E FOKUSIT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 15.10.2020 deri më 20.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Një udhëzues bisede me 10 pyetje

Numri i grupeve të fokusit:

6 grupe të fokusit

Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve:

36 pjesëmarrës (mesatarisht 6 pjesëmarrës për fokus grup)

Kriteret për përzgjedhjen e pjesëmarrësve:

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit u zgjedhën bazuar në kriteret e mëposhtme: gjinia, moshë, vendbanimi, punësimi (këtu u përpoqëm të përfshijmë të punësuar në institucione publike, sektorin privat, por edhe sektorin civil dhe mediat).

INTERVISTAT

Periudha:

Hulumtimi u realizua në periudhën nga 15.10.2020 deri më 11.11.2020.

Instrumenti i hulumtimit:

Udhëzues për intervistë me 5 pyetje

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve:

6 të intervistuar

Kriteret për zgjedhjen e bashkëbiseduesve:

zgjodhëm bashkëbisedues që janë të punësuar në institucione, si dhe ata nga sektori civil dhe media që shpesh kanë kontakte me institucione.

3. Rezultatet e hulumtimit

Bashkëpunimi dhe komunikimi i qeverive lokale me qytetarët

Kur është fjala se sa të hapura janë qeveritë lokale, të anketuarit e intervistuar përmes intervistave të thelluara dhe grupeve të fokusit theksuan se ekziston një nivel i caktuar komunikimi midis këtyre institucioneve dhe qytetarëve. Sidoqoftë, të anketuarit gjithashtu theksojnë se komunikimi ekzistues është i pamjaftueshëm dhe se një angazhim më i madh dhe më i mirë i institucioneve është i nevojshëm për sa i përket hapjes ndaj qytetarëve dhe nxitjes së qytetarëve për të përdorur mundësitë ligjore në dispozicion për komunikim me institucione.




Qytetarët e anketuar përmes sondazhit kryesisht mendojnë se përfaqësuesit e tyre në qeveritë lokale nuk janë të gatshëm të dëgjojnë dhe respektojnë pikëpamjet e qytetarëve. 73.7% e tyre u përgjigjën se mendojnë se përfaqësuesit e tyre nuk janë ose kryesisht nuk janë të hapur për pikëpamjet e qytetarëve, ndërsa 20.5% mendojnë se ata janë kryesisht ose plotësisht të hapur.

Mendimet janë të ndara kur bëhet fjalë se sa janë të hapura qeveritë lokale ndaj qytetarëve. Përfaqësuesit e intervistuar të qeverive lokale nga jugu i Kosovës besojnë se këto institucione janë mjaft të hapura për qytetarët. Për shembull, përfaqësuesi i komunës së Graçanicës pretendon se institucionet e vetëqeverisjes lokale në këtë komunë janë plotësisht të hapura për publikun. Si shembull thekson se Zyra e Kryetarit të Komunës në Graçanicë është e hapur për qytetarët, dhe se takimet dhe bisedat e drejtpërdrejta janë zhvilluar me më shumë se 2,000 qytetarë në këtë komunë, dhe se ka një bashkëpunim domethënës me shoqërinë civile.

Nga ana tjetër, e anketuara nga Graçanica, përfaqësuesja e një institucioni tjetër, thekson se "komuna është e gatshme të dëgjojë, por jo të marrë parasysh mendimet, problemet, sugjerimet e qytetarëve". Qytetarët kanë qasje në komunë dhe tek zyrtarët komunalë, por shumica e punëve, projekteve, konkurseve zhvillohen në mënyrë jo transparente dhe me procedura të paqarta. (...) Mbizotëron nepotizmi, përkatësia partiake, lidhjet personale, etj."

Qytetarët e anketuar përmes sondazhit kryesisht mendojnë se përfaqësuesit e tyre në qeveritë lokale nuk janë të gatshëm të dëgjojnë dhe respektojnë pikëpamjet e qytetarëve. 73.7% e tyre u përgjigjën se mendojnë se përfaqësuesit e tyre nuk janë ose kryesisht nuk janë të hapur për pikëpamjet e qytetarëve, ndërsa 20.5% mendojnë se ata janë kryesisht ose plotësisht të hapur.

Grafiku 1. A mendoni se përfaqësuesit tuaj në qeverinë lokale janë të hapur për të dëgjuar dhe respektuar pikëpamjet e qytetarëve?



Përfaqësuesit e sektorit civil nga veriu i Kosovës, bazuar në përvojën e tyre, thonë se qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile përballen me vështirësi të mëdha në përpjekjen për të komunikuar me zyrtarët qeveritarë në nivelet lokale dhe qendrore. Këta të anketuar besojnë se përfaqësuesit në institucione nuk ndihen të përgjegjshëm ndaj të gjithë qytetarëve dhe se komunikimi bazohet kryesisht në njohjet personale. Disa nga arsyet e një situatë të tillë janë personat jo kompetente në pozita vendimmarrëse që shpesh as nuk e dinë që roli i tyre është përfaqësimi i qytetarëve, por gjithashtu edhe përfaqësuesit politikë serb që nuk e ndiejnë nevojën për të "përfitur" qytetarët, sepse e kanë mbështetjen e Beogradit, i cili i mban ata në pushtet.

Disa përfaqësues të institucioneve gjithashtu besojnë se ka shumë hapësirë për përmirësim të bashkëpunimit midis qytetarëve dhe institucioneve, duke vërejtur se ka mungesë të komunikimit dhe bashkëpunimit të vërtetë midis qytetarëve dhe institucioneve jashtë kornizës së detyrimeve zyrtare.

"Përgjegjësia është kryesisht e përfaqësuesve të qeverive lokale, të cilët duhet të jenë më këmbëngulës në mënyrë që të bindin qytetarët të jenë më aktivë." Nëse qytetarët do të besonin se ata me të vërtetë marrin pjesë në proceset vendimmarrëse, be-


soj se pjesëmarrja e tyre do të ishte më cilësore" (përfaqësuesja e institucionit nga Mitrovica e Veriut).

Pastaj, njëri nga problemet e spikatura është se qytetarët nuk janë të informuar se kush janë përfaqësuesit e tyre në Kuvendet Komunale, përkatësisht këshilltarët, dhe se arsyeja për këtë qëndron në mungesën e komunikimit të përfaqësuesve lokalë me qytetarët. Të anketuarit besojnë se institucionet nuk e dëgjojnë ose këshillohen vërtet me popullatën. Vlerësohet se përfaqësuesit në kuvende rrallë marrin fjalën për të avokuar për zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë qytetarët.

Bashkëpunimi dhe komunikimi i institucioneve qendrore me qytetarët

Duke shqyrtuar bashkëpunimin dhe komunikimin e institucioneve qendrore me qytetarë, kryesisht iu referuam komunikimit të përfaqësuesve në Kuvendin e Kosovës dhe Qeverinë e Kosovës me publikun. Me marrjen e detyrës, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Kosovës zotohen që të përfaqësojnë popullin dhe të punojnë në interes të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Grafiku 2. A mendoni se përfaqësuesit serbë në Kuvendin e Kosovës komunikojnë sa duhet me qytetarët?



Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për komunikim midis qytetarëve dhe përfaqësuesve në institucionet qendrore, shumica e të anketuarve me të cilët biseduam përmes intervistave të thelluara besojnë se ky komunikim pothuajse mungon plotësisht. Një mendim të ngjashëm ndajnë edhe qytetarët e anketuar, ku 80% e tyre besojnë se përfaqësuesit serbë në Kuvendin e Kosovës nuk komunikojnë sa duhet me qytetarët.

Disa të anketuar besojnë se deputetët nuk janë të obliguar për t'u konsultuar (drejtpërdrejt) me qytetarët, mirëpo duhet të veprojnë kështu përmes iniciativave qytetare dhe organizatave joqeveritare. Sidoqoftë, theksohet se kjo gjithashtu ndodh "shumë rrallë dhe vetëm me lobim të madh të sektorit civil dhe organizatave ndërkombëtare" (përfaqësuesja e një institucioni nga Graçanica). Për më tepër, të anketuarit që vijnë nga institucionet deklarojnë se vetëqeverisja lokale është ajo që krijon kontakte të drejtpërdrejta me qytetarët dhe se përfaqësuesit e zgjedhur në pushtetin ekzekutiv janë vetëm bartës të zërit të qytetarëve në nivelin qendror.

Pastaj, disa të anketuar, si nga institucionet ashtu edhe nga sektori civil, besojnë se komunikimi i drejtpërdrejtë i përfaqësuesve në institucione qendrore me qytetarët bëhet kryesisht para zgjed-

hjeve, kur është e nevojshme për të bindur njerëzit të votojnë, dhe se atëherë komunikimi zhvillohet përgjatë vijave të partisë, edhe vetë qytetarët dyshojnë në objektivitetin me rastin e paraqitjes së nevojave reale.

Duke iu referuar qasshmërisë së të gjitha institucioneve të Kosovës për qytetarët serbë, një i anketuar nga sektori civil deklaroi se këto institucione nuk kanë bërë sa duhet për të integruar popullsinë serbe në kornizën institucionale të Kosovës, as për përfshirjen e vërtetë të këtyre qytetarëve.

Besimi i qytetarëve në institucione

Të anketuarit kryesisht besojnë se shumica e qytetarëve nuk u besojnë institucioneve. Një nga arsyt kryesore për këtë është priorizimi i marrëdhënieve partiake dhe njohjet personale.

Disa të anketuar nga sektori civil theksojnë se qytetarët serbë nuk u besojnë institucioneve të Kosovës, sepse janë të dobëta dhe të korruptuara. Këta të anketuar besojnë se besimi i qytetarëve në institucionet serbe, përfshirë institucionet e arsimit, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, është shumë më i lartë në krahasim me besimi për ato kosovare.


Një nga arsyet është se institucionet e Kosovës nuk kanë bërë sa duhet për të integruar në thelb qytetarët serbë, kështu që ata janë të orientuar drejt institucioneve serbe, të cilat u ofrojnë atyre shërbime të caktuara, përfitime dhe u japin hapësirë për zgjidhjen e problemeve të tyre.

Për shembull, një mendim tjetër ka përfaqësuesi i komunës së Graçanicës i cili konsideron se besimi i qytetarëve në komunën e Graçanicës është i

padiskutueshëm, dhe se provë është që qytetarët u drejtohen atyre personalisht dhe drejtpërdrejt, gjë që, sipas mendimit të tij, reflekton një dozë të kënaqshme besimi.

Gjatë anketimit, i pyetëm qytetarët nëse dhe në cilat institucione ata drejtohen kur duan të marrin informata të rëndësishme, ku 59.6% e qytetarëve u përgjigjën se u drejtohen institucioneve serbe, dhe 39.1% të Kosovës.

Grafiku 3. A i kontaktoni institucionet përgjegjëse kur dëshironi të merrni informata të rëndësishme (informacion mbi buxhetin e komunës, vendet e lira të punës, prokurimin publik, investimet kapitale, etj.)?




Sidoqoftë, përmes një diskutimi në grupin e fokusit të realizuar pas anketimit të qytetarëve, kuptuam se ky rezultat ka pak gjasa të pasqyrojë pamjen reale për tërë Kosovën. Gjegjesisht, institucionet që mund të ofrojnë informacione mbi buxhetin e komunës, prokurimin publik, investimet kapitale janë kryesisht qeveritë lokale dhe institucionet qeveritare. Sidoqoftë, qeveritë lokale nën sistemin serb në Kosovë kanë humbur shumicën e kompetencave të tyre, veçanërisht në jug të Kosovës, dhe përfaqësuesit serb në qeverinë e Kosovës janë pjesë e sistemit të Kosovës. Nga ana tjetër, institucionet shëndetësore dhe arsimore janë ende duke funk-

sionuar, mirëpo ato mund të japin vetëm një pjesë të informacionit nga pyetja e mëparshme, pra, më së shpeshti atë për vendet e lira të punës.

Specifikuam pyetjen në mënyrë që të zbulojmë se çfarë mendimi kanë qytetarët për vetëqeverisjet lokale, domethënë nëse ata mendojnë se qeveritë lokale serbe apo kosovare do t'i përgjigjen kërkesës së tyre në mënyrë më efektive. Ngjashëm me rezultatin e mëparshëm, 66.2% e qytetarëve besojnë se qeveria lokale serbe dhe 19.8% qeveria lokale e Kosovës do të përgjigjet në mënyrë më efektive, ndërsa 14% nuk u përgjigjën.

Grafiku 4. Cila qeveri lokale mendoni se do t'i përgjigjet në mënyrë më efektive kërkesës suaj?



Kur zbërthejmë të dhënat e marra sipas shtrirjes gjeografike të të anketuarve, mund të shohim se në mesin e të anketuarve nga jugu dhe veriu nuk ka ndryshime të konsiderueshme në përgjigjet e kësaj pyetje. Gjegjësisht, rreth 71.20% e të anketuarve nga jugu i Kosovës u përgjigjën se ata mendojnë se vetëqeverisja lokale serbe do t'i përgjigjet në mënyrë më efektive në kërkesat e tyre, dhe 61.1% e të anketuarve nga veriu i Kosovës dhanë të njëjtën përgjigje. Nga ana tjetër, 26% e të anketuarve nga jugu besojnë se qeveria lokale e Kosovës do t'i përgjigjej më me efektshmëri kërkesës së tyre, ndërsa përqindja e të anketuarve nga veriu që ndajnë këtë mendim është 13.6%.

Pjesëmarrësit e grupeve të fokusit të cilët janë anëtarë të sektorit civil vlerësuan se faktori emocional ka shumë mundësi të ketë mbizotëruar në mesin e qytetarëve kur u përgjigjen dy pyetjeve të mëparshme, duke pasur parasysh që, siç thonë ata, institucionet e Kosovës padyshim që kanë kompetencë më të madhe në terren, dhe se kompetenca e qeverisë lokale serbe është zvogëluar në minimum.


Për më tepër, të anketuarit pretendojnë se ekziston një ndryshim i madh në transparencë në mes të institucioneve të Kosovës në veri dhe atyre në jug të Kosovës. Bazuar në përvojat e tyre personale,

qytetarët vlerësuan se institucionet e Kosovës në jug janë më funksionale dhe më të përgjegjshme sa i përket transparencës dhe ofrimit të shërbimeve. Si një nga arsytet e mundshme për këtë gjendje, të anketuarit theksojnë faktin se qeveritë lokale të Kosovës në jug u krijuan shumë më herët sesa ato në veri, dhe se në të njëjtën kohë qeveritë lokale serbe u shuan shumë më herët në jug në krahasim me ato në veri, ku janë ende të dukshme.

Po ashtu, është interesante të theksohet se në veri të Kosovës, shumica e qytetarëve as nuk e dinë ndryshimin midis qeverive lokale serbe dhe atyre të Kosovës, duke pasur parasysh që ato shpesh janë të vendosura në të njëjtat ndërtesa dhe nuk është e qartë nëse diçka zbatohet nga një institucion i Kosovës apo serb.

Në fund, gjatë anketimit, i pyetëm qytetarët për përvojat e tyre me autoritetet dhe institucionet e Kosovës, në rast të kontaktit me to. 38.7% e të anketuarve kishin një përvojë të kënaqshme, ndërsa një përqindje e përafërt prej 38.9% e të anketuarve ishin të pakënaqur me përvojën me institucionet dhe/ose autoritetet e Kosovës.

Grafiku 5. Në rast se i jeni drejtuar autoriteteve dhe/ose institucioneve të Kosovës, si do ta vlerësonit përvojën tuaj personale?



Informimi i qytetarëve nga institucionet

Informimi i qytetarëve është një hap i rëndësishëm drejt transparencës së punës së institucioneve. Në mënyrë që të marrin pjesë në vendimmarrje dhe zgjidhje të problemeve së bashku me komunën e tyre dhe të ndikojnë në vendimet e marra në nivelin qendror, qytetarët para së gjithash duhet të jenë të mirinformuar.

Para se të pyetnim të anketuarit nëse ata mendojnë se qytetarët janë të informuar mirë për punën e institucioneve, i pyetëm nëse ka interesim në mesin e qytetarëve për ngjarjet dhe proceset institucionale, si dhe se ku është më i përhapur interesimi i qytetarëve.

Interesimi dhe gatishmëria e qytetarëve për t'iu drejtuar institucioneve

Kur bëhet fjalë për informimin e qytetarëve rreth punës së institucioneve dhe ofrimin e informatave me rëndësi publike nga institucionet, së pari pyetëm se çfarë i intereson më shumë qytetarët. A janë më të interesuar qytetarët për çështje që kanë të bëjnë me probleme të një natyre personale, apo çështje që kanë të bëjnë me të mirën personale dhe atë publike? A është më i pranishëm interesimi i qytetarëve kur bëhet fjalë për probleme komunale, apo dokumente publike, apo a janë

më të interesuar për lajmet në lidhje me konkursat për punësim, subvencione dhe kompensime të ngjashme monetare?

Sipas një numri më të madh të anketuarve, qytetarët janë më të interesuar për çështje që lidhen me interesat e tyre personale, ose diçka që ndikon drejtpërdrejt në jetën e tyre të përditshme, ndërsa ka një mungesë interesimi për interesin e përgjithshëm dhe çështjet që nuk kanë ndikim të menjëhershëm por të qëndrueshëm në jetën e përditshme të qytetarëve, sikurse miratimi i rregulloreve, ligjeve, debatet në kuvendet komunale ose puna e institucioneve qendrore. Ekziston një mungesë e vetëdijes së qytetarëve për ndikimin e çështjeve me rëndësi të përgjithshme në jetën e tyre dhe një mungesë e vetëdijes dhe gatishmërisë për të marrë pjesë në krijimin ose ndryshimin e politikave.

Për shembull, përfaqësuesi i komunës së Graçanicës thekson se interesimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve në këtë komunë nuk është në një nivel të kënaqshëm, dhe se kjo është një fushë ku ka hapësirë të konsiderueshme për përmirësim. Ai thekson se qytetarët komunës së Graçanicës kryesisht i janë drejtuar për zgjidhjen e problemeve komunale dhe infrastrukturore, si dhe me kërkesa për mbështetje sociale, ndihmë të menjëhershme, çështje ekonomike dhe punësim.

Sidoqoftë, shumë të anketuar theksuan se në Kosovë është e pranishme vetëdija e ulët e qytetarëve për ato shërbime dhe informacione që ata mund të marrin nga institucionet, veçanërisht qeveritë lokale. Të anketuarit gjithashtu theksuan mendimin se qytetarët nuk janë të vetëdijshëm se institucionet janë në shërbim të qytetarëve, dhe jo e kundërta.

Kur u pyetën se kënd e konsiderojnë përgjegjës për pasivitetin e qytetarëve, disa të anketuar besojnë se përgjegjësia bie kryesisht në institucione dhe se duhet të punojnë në mënyrë aktive për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për rolin dhe punën e institucioneve. Nga ana tjetër, disa të anketuar besojnë se përgjegjësia më e madhe është e qytetarëve, individëve, të cilët duhet të dalin nga korniza inerciale dhe të fillojnë të përdorin më shumë mundësi në dispozicion të tyre për të bashkëpunuar me institucione.

“Janë njerëzit ata që krijojnë institucione, por edhe ata që i shkatërrojnë ato. Pra, ata që janë të punësuar në institucione nuk duan të ndryshojnë asgjë, sepse janë mirë aty ku janë. Individët janë ata që duhet t’i ndryshojnë gjërat, nëse diçka nuk u përshtatet atyre.”, thotë i anketuari nga Mitrovica e Veriut.

Informimi i qytetarëve rreth punës së institucioneve

Shumica e të anketuarve përmes intervistave të thelluara theksuan se informimi i qytetarëve nga qeveritë lokale nuk është mjaftueshëm transparent dhe se ka mungesë informacioni, veçanërisht kur nuk është i favorshëm për autoritetet. Theksohet, gjithashtu se zyrtarët komunalë dhe zyrtarët e tjerë publik nuk janë të vetëdijshëm që qytetarët kanë të drejtë të kërkojnë informata dhe dokumente të caktuara të cilat duhet të jenë publike. Informimi i dobët gjithashtu u vu re kur bëhet fjalë për shërbime komunale, të tilla si mungesa e energjisë elektrike dhe ujit, cilësia e ujit të pijshëm, dëmet e shkaktuara nga moti dhe të ngjashme. Qytetarët zakonisht informacionet e tilla i marrin nga mediat.

“Ndodh që kemi tre ditë energji elektrike pandërprerë, por edhe të kemi mungesë prej pesë deri në

shtatë orë në ditë, të paktën në pjesën ku jetojmë. Kjo ndodh kur ka punime në rrjete, apo rregullime, madje edhe ne si institucion nuk kemi njoftim se mund të ketë ndërprerje të energjisë elektrike për dy orët e ardhshme», thotë një i anketuar nga Leposaviqi, i cili është i punësuar në qeverinë lokale të Kosovës.

Për më tepër, qytetarët u ankuan se as informacioni në lidhje me vendet e lira të punës nuk arrin deri tek institucionet, por gjithashtu besojnë se institucionet me qëllimin veprojnë kështu për ta bërë këtë informacion sa më të padukshëm.

Sipas fjalëve të disa të anketuarve, publikimi i informacionit në faqet zyrtare të komunave nuk është në kohë, dhe mediat lokale kryesisht publikojnë informacione që korrespondojnë me zyrtarë qeveritarë ose struktura partiake, që shpjegohet nga të anketuarit me vërejtjen se një numër i madh i mediave në Kosovë ndikohen nga strukturat qeverisëse. Këta të anketuar gjithashtu theksojnë se kontaktet e përfaqësuesve të pushtetit lokal dhe informimi i qytetarëve rreth aktiviteteve dhe punës së tyre rritet ndjeshëm gjatë fushatës parazgjedhore, por edhe jashtë fushatës.

Nga ana tjetër, dy të anketuar nga institucionet e qeverisë lokale në jug të Kosovës janë të mendimit të kundërt, duke theksuar se komuna e Parteshit dhe Graçanicës rregullisht informojnë qytetarët përmes ueb faqes zyrtare, rrjeteve sociale dhe tabelave të shpalljes dhe se “të gjitha temat dhe aktivitetet janë të mbuluara” (përfaqësuesi i komunës Graçanicë).

Një nga vërejtjet lidhur me informimin e qytetarëve për punën e institucioneve në nivelin qendror është se institucionet me karakter lokal në mënyrë arbitrarë dhe jo të mjaftueshme informojnë qytetarët për vendimet e qeverisë qendrore, më së shpeshti kur ka ndonjë problem, për shembull, anulimi i vendeve të punës. Theksohet se shpesh ka mungesë të informacionit të tipit qendror dhe informim të pamjaftueshëm të qytetarëve për to.

Informimi i qytetarëve për punën e institucioneve në nivelin qendror, sipas të anketuarve nga intervistat e

thelluara, bëhet kryesisht përmes faqeve zyrtare të Kuvendit, ministrive, si dhe nga mediat. Disa të anketuar theksuan se ky lloj informimi duhet të jetë në një nivel shumë më të mirë dhe më të lartë, ku një nga problemet është përkthimi i dobët në gjuhën serbe.


Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultime dhe seanca publike të Kuvendeve Komunale

Të gjitha seancat e Kuvendit Komunal janë të hapura për publikun, dhe njoftimi për mbajtjen e një seance të rregullt me ligj duhet të publikohet me njoftim paraprak prej 7 ditë pune, dhe 3 ditë pune paraprakisht nëse është një seancë e jashtëzakonshme.¹⁴ Përveç informacionit bazë, njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës dhe materialet përcjellëse për seancë në mënyrë që të informojë qytetarët paraprakisht për temat dhe ti përgatisë ata për ndjekje.

Komuna gjithashtu ka një detyrim ligjor për të siguruar hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut. Në këtë drejtim, secila komunë duhet të organizojë të paktën dy takime publike në vit, përkatësisht konsultime me qytetarët, për çështje me interes të përgjithshëm. Përveç konsultimeve të detyrueshme, ligji përcakton që komuna duhet të mbajë takime shtesë në mënyrë që të afrohet sa më shumë me qytetarët për sa i përket buxhetit, zhvillimit ekonomik lokal, planifikimit hapësinor dhe të ngjashme.¹⁵ Kryetari i komunës gjithashtu është i detyruar të marrë pjesë në takime publike me qytetarë, i cili duhet të njihet drejtpërdrejt me problemet e qytetarëve dhe të dëgjoj sugjerimet e tyre për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Në mënyrë që publiku të informohet në kohën e duhur, njoftimi publik për mbajtjen e seancave të Kuvendit të Komunës dhe konsultimet publike duhet të vendoset në vendet më të frekuentuara brenda komunës, të dërgohet për mediat e


Grafiku 6. A merrni njoftime në kohë nga komuna juaj për kohën e konsultimeve publike me qytetarë dhe seancave të hapura për publikun në Kuvendin e Komunës?



14 Udhëzimi Administrativ i MAPL-së nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

15 Udhëzimi Administrativ i MAPL-së nr. 01/2015 për transparencë në komuna

Grafiku 7. Si informoheni për mbajtjen e konsultimeve publike me qytetarë në Kuvendin e Komunës?



shkruara dhe elektronike dhe të publikohet në ueb faqen zyrtare të komunës dhe rrjetet sociale. Rregullat e njëjta të publikimit vlejnë edhe për të gjitha vendimet, udhëzimet dhe dokumentet e tjera të Kuvendit të Komunës, përveç në rastet kur shpallja e tyre është e kufizuar nga Ligji për Qasjen në Dokumente Publike.¹⁶

Shumica e qytetarëve (72.8%) të anketuar me pyetësor thanë se nuk marrin njoftime në kohë nga komunat e tyre për kohën e mbajtjes së konsultimeve publike dhe seancave të Kuvendit të Komunës të hapura për publikun, ndërsa 18% thanë se marrin njoftime në kohë.

Ka pasur mendime të ndryshme gjatë diskutimeve në grupet e fokusit dhe intervistat e thelluara.

Përfaqësuesi i komunës së Parteshit thotë se konsultimet publike në këtë komunë mbahen të paktën dy herë në vit, por që këtë vit, për shkak të situatës së pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, nuk ishte e mundur të mbaheshin më shumë debate publike. Dhe të anketuarit e tjerë që janë përfaqësues të qeverive lokale gjithashtu thonë se njoftimet dhe ftesat për konsultime dhe

seanca publike të hapura për publikun drejtuar qytetarëve publikohen rregullisht në ueb faqet e komunave dhe rrjeteve sociale.

Nga ana tjetër, disa të anketuar nga sektori civil konfirmuan që njoftimet publikohen, por shtuan se shpesh publikimet bëhen në periudhë prej një ose dy ditë para ngjarjes, e që është më shkurt në krahasim me afatin ligjor prej të paktën 7 ditësh. Gjithashtu, disa të anketuar, si nga jugu ashtu edhe nga veriu, thonë se qeveritë lokale organizojnë debate publike me qytetarë vetëm për ato tema për të cilat kanë detyrim ligjor për të organizuar një debat publik.

Ekziston, gjithashtu një besim se përfaqësuesit e qeverive lokale nuk po bëjnë sa duhet për të përfshirë qytetarët në vendimmarrje. Nga ana tjetër, theksohet se ka mungesë të interesimit të qytetarëve për të marrë pjesë në ngjarje të tilla, sepse dyshojnë se mund të shpie në ndryshime pozitive.

“Seancat publike të hapura për publikun ekzistojnë, (...) megjithatë, qytetarët nuk iu përgjigjen, si rrjedhojë e një praktike të tillë që nuk ekziston prej vitesh ose ekziston por në një masë më të vogël. Pra, në ato seanca, mund të vërenim se një numër i madh i qytetarëve nuk ishin të pranishëm, se nuk mund të dëgjoreshin propozime të ndryshme,

16 Udhëzimi Administrativ i MAPL-së nr. 01/2015 për transparencë në komuna

se thjesht kishte mungesë të një mendimi tjetër. Institucionet në Leposaviq, konkretisht, për vite me radhë (dhe kjo nuk ka të bëjë vetëm me këtë qeveri, por edhe me ato të mëparshmet), nuk dinin si të dëgjonin qytetarët, nuk i lejonin qytetarët të merrnin pjesë në një mënyrë produktive”, tha një përfaqësues i mediave nga kjo komunë e veriut të Kosovës.

Me qëllim të përcaktimit të mënyrave më të shpeshta të informimit të qytetarëve në lidhje me mbajtjen e konsultimeve publike me qytetarë në Kuvendin e Komunës, gjatë anketimit parashtroam këtë pyetje për qytetarët. Qytetarët cekën rrjetet sociale (44.8%), kontaktet personale (34.7%), ueb faqet e komunave (32.6%), tabelat e shpalljeve në komuna (28.4%) dhe mediat (24.5%) si burimet më të zakonshme të informimit për këtë temë.¹⁷


Sidoqoftë, një ndryshim i konsiderueshëm në përgjigjet e kësaj pyetje duhet të përmendet në mesin e të anketuarve nga jugu dhe atyre nga veriu i Kosovës. Gjegjesisht, rreth 52.4% e të anketuarve nga veriu i Kosovës informohen

përmes kontakteve personale, ndërsa numri i banorëve nga jugu është dy herë më i ulët dhe arrin në 26.6%. Gjithashtu, banorët e veriut të Kosovës informohen më shpesh përmes mediave (49.2% e tyre) në krahasim me banorët e komunave me shumicë serbe në jug (13.2%). Nga ana tjetër, banorët nga jugu shumë më shpesh përdorin ueb faqet e komunave për t'u informuar rreth konsultimeve publike (40.3% e të anketuarve), dhe në veri përqindja e qytetarëve që përdorin këto kanale të komunikimit është dukshëm më e ulët (15.6%).

Sjellja e institucioneve gjatë pandemisë Covid-19

Përmes intervistave të thelluara, grupeve të fokusit dhe pyetësorëve, ne gjithashtu kërkuam të zbulojmë nga të anketuarit se si e vlerësojnë ata sjelljen e institucioneve gjatë krizës së shkaktuar nga pandemia Covid-19, e cila vazhdon edhe gjatë përpilimit të këtij raporti.

Grafiku 9. A ishin shtabet e krizave në komunat e Kosovës gjatë pandemisë Covid-19 të gatshëm për t'iu përgjigjur nevojave urgjente të qytetarëve?



¹⁷ Kjo pyetje përmbante mundësinë e më shumë përgjigjeve.

Të anketuarit me të cilët kemi biseduar përmes intervistave të thelluara në përgjithësi vlerësuan se institucionet kanë vepruar me përgjegjësi dhe profesionalizëm. Të anketuarit gjithashtu theksuan se reagimet e institucioneve ishin në një nivel të kënaqshëm dhe në përputhje me kapacitetet, të cilat, thonë se janë shumë të kufizuara kur bëhet fjalë për sistemin shëndetësor. Institucionet shëndetësore dhe personeli i tyre mjekësor janë institucione më të dalluara që i janë përgjigjur në mënyrë më efektive krizës.


Opinionet e qytetarëve të anketuar ishin të ndara sa i përket gatishmërisë së shtabeve të krizave në përgjigje të nevojave të qytetarëve. Rreth 45% e të anketuarve besojnë se shtabet e krizave nuk i kanë përmbushur pritjet në këtë drejtim, ndërsa 44.6% e të anketuarve besojnë se i kanë përmbushur.

Sidoqoftë, disa pjesëmarrës në intervista të thelluara theksuan ekzistencën e informacionit të paqartë në lidhje me respektimin e masave në veri të

Kosovës në fillim të epidemisë. Përderisa pranonim informata për masat si nga institucionet serbe ashtu edhe nga institucionet e Kosovës, nuk ishte e qartë se cilat masa do të duhet të respektonin. Mirëpo siç e shpjeguan, kjo më vonë ndryshoi, kështu kufizimet në lëvizje dhe sjellja gjatë epidemisë u bënë më të qarta.

Sipas disa të anketuarve që gjatë pandemisë kishin përvojë personale me institucione, kjo krizë ka ndikuar që disa institucione të jenë më të hapura ndaj qytetarëve dhe "ka përmirësuar pak përshtypjen kur bëhet fjalë për qeverinë lokale; meqenëse si gazetar e ndoqa këtë situatë, mendoj se tani ishin shumë më të hapura për bisedë, kishin konsideratë për të gjitha mediat (...) kështu që gjatë pandemisë në vazhdim morëm informacionin e duhur, madje patëm bashkëpunim të mirë me shtabin e krizave dhe Shtëpinë e shëndetit në Leposaviq (...) dhe autoritetet kompetente gjithashtu reagonin shpejt kur plasoheshin dezinformatat." (gazetar, komuna e Leposaviqit)

Grafiku 10. Sipas mendimit tuaj, cili nga institucionet e mësipërme iu përgjigj në mënyrë më efektive dhe profesionale krizës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19 në Kosovë?



Gjithashtu, disa të anketuar theksuan se shtabet e krizave, përgjegjëse për informimin e publikut me masat e marra dhe informacione të tjera në lidhje me Covid-19, janë bërë më të hapura për publikun pas kritikave nga disa organizata të shoqërisë civile dhe media.

Përveç shtabeve të krizave, ne gjithashtu ishim të interesuar për qëndrimin e qytetarëve ndaj reagimit të institucioneve të tjera ndaj krizës së shkaktuar nga koronavirusi. Përmes anketës, i pyetëm qytetarët se cili nga institucionet e përmendura i është përgjigjur krizës në mënyrën më efektive dhe profesionale. Përqindja më e madhe e qytetarëve besojnë se Ministria e Shëndetësisë e Serbisë (45.2%) dhe Qendra Spitalore Klinike në Mitrovicë (40.7%) dhe klinikat lokale (40.7%) reagojnë në mënyrë më efektive. Pastaj Qeveria e Serbisë me 22.7% dhe shtabet komunale të krizave me 16.4%.

Sidoqoftë, qytetarët e intervistuar përmes grupit të fokusit besojnë se përgjigjet në këtë pyetje kryesisht ishin të udhëhequra nga emocionet sesa nga përvoja reale.

Vëzhgimet që përfshijnë mangësi në veprimet e institucioneve janë mungesa e një plani strategjik gjithëpërfshirës për të luftuar Covid-19, zbatimin jo të kënaqshëm të procesit të ndihmës sociale nga institucionet dhe gjatëgjatësi selektive e qytetarëve nga Policia e Kosovës për mosrespektim.

Qytetarët që ishin pjesë e programit të ndihmës sociale thonë se informacioni u transmetua përmes kontakteve personale dhe medias, ndërsa ata nuk morën asnjë informacion nga institucionet në lidhje me aprovimin e ndihmës, alokimin dhe datat kur mund të merret ndihma. Edhe pse kërkesat u parashtruan,

"I gjithë komunikimi u zhvillua përmes mikut i cili vinte deri tek ato informacione nga dikush që punon në institucione, gjë që çoi në informacion gjysmak nëse jam apo jo në listë, do të ketë apo nuk do të ketë pagesa. Pas 12 orësh pritje, kur mora paratë, u habita që edhe kishte para, sepse dëgjova që për disa që ishin pas meje në radhë, nuk kishte



Policia e Kosovës gjithashtu është kritikuar nga të anketuarit nga veriu i Kosovës për gjatëgjatësi selektive për mosrespektim të masave epidemiologjike. Gjegjësisht, sikurse theksojnë qytetarët nga grupet e fokusit në veri të Kosovës, gjatëgjatësi për mos mbajtjen e maskës u ishin shqiptuar qytetarëve në mënyrë selektive, kështu që për të njëjtën shkelje disa janë gjatëgjatësi e disa jo. Po ashtu, sipas qytetarëve, disa objekte hoteliere nuk ishin sanksionuar kur numri i personave të pranishëm ishte më i lartë nga ai i lejuar, përderisa disa të tjerë po.

para", tha një qytetar nga komuna e Leposaviqit gjatë grupit të fokusit, duke shtuar se masat epidemiologjike nuk janë respektuar gjatë ndarjes së ndihmës, madje edhe në prani të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Policia e Kosovës gjithashtu është kritikuar nga të anketuarit nga veriu i Kosovës për gjatëgjatësi selektive për mosrespektim të masave epidemiologjike. Gjegjësisht, sikurse theksojnë qytetarët nga grupet e fokusit në veri të Kosovës, gjatëgjatësi për mos mbajtjen e maskës u ishin shqiptuar qytetarëve në mënyrë selektive, kështu që për të njëjtën shkelje disa janë gjatëgjatësi e disa jo. Po ashtu, sipas qytetarëve, disa objekte hoteliere nuk ishin sanksionuar kur numri i personave të pranishëm ishte më i lartë nga ai i lejuar, përderisa disa të tjerë po.

Të anketuarit nga jugu i Kosovës, nga ana tjetër, e renditën Policinë e Kosovës si një nga institucionet që u përgjigjën në mënyrë më efektive gjatë pandemisë.

4. Përfundimet

Me këtë hulumtim konstatuam se, përderisa ekziston pa dyshim një nivel i caktuar komunikimi dhe dialogu midis institucioneve dhe qytetarëve, ai përgjithësisht mbetet në nivelin informativ.

Informimi i mirë është pjesë përbërëse e transparencës, e cila duhet të bazohet jo vetëm në sigurimin e informacionit në një nivel minimal (siç ndodh, për shembull, kur institucionet publikojnë informacion vetëm në një kanal komunikimi, të themi në ueb faqen zyrtare), por gjithashtu edhe duke u siguruar që ky informacion të arrijë sa më shumë qytetarë.

Mënyrat e informimit të qytetarëve janë të ndryshme dhe kryesisht varen nga mosha, qasja në internet, mundësia e qasjes në një institucion të caktuar, etj. Këto mënyra zakonisht përfshijnë kontakte personale, sociale, rrjete dhe media. Mënyra e informimit të qytetarëve gjithashtu varet nga fakti nëse të gjitha mënyrat e informimit të parapara me ligji janë të siguruara dhe funksionale. Kështu, për shembull, një nga gjetjet është se qytetarët në jug të Kosovës përdorin ueb faqet zyrtare të komunave me shumicë serbe më shumë sesa qytetarët në veri. Kjo ndoshta për arsye se ueb faqet zyrtare të komunave në veri nuk janë funksionale, kështu që për t'u informuar qytetarët më shumë përdorin kanale tjera.

Kur bëhet fjalë për besimin, gjetjet treguan se nuk ka besim të mjaftueshëm të qytetarëve në institucione, si në lokale ashtu edhe në ato qendrore. Komunikimi midis institucioneve dhe qytetarëve

është i kufizuar dhe i njëanshëm. Ligji përcakton se kjo mënyrë e komunikimit është e pamjaftueshme dhe se institucionet duhet të zhvillojnë një dialog aktiv me qytetarët. Sidoqoftë, problemi është se qytetarët janë mësuar me faktin se pjesëmarrja e tyre nuk është e dëshirueshme dhe se zëri i tyre nuk respektohet me të vërtetë, kështu që në proceset e konsultimeve marrin pjesë vetëm formalisht ose nuk marrin pjesë fare.

Ka shembuj pozitivë në disa komuna me shumicë serbe, ku kryetarët e komunave kanë iniciuar praktikën e takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët dhe diskutimin e problemeve të tyre. Sidoqoftë, nuk ka asnjë informacion në dispozicion të publikut në lidhje me atë që po ndodh me kërkesa të tilla të qytetarëve dhe sa prej problemeve të paraqitura në të vërtetë zgjidhen. Gjithashtu, një iniciativë e tillë u përmend vetëm në kontekstin e zgjidhjes së problemeve të qytetarëve, dhe jo për qëllim të konsultimit të qytetarëve nga përfaqësuesit e institucioneve për politikëbërje ose vendimmarrje. Prandaj, megjithëse janë një shembull i mirë i dialogut midis institucioneve dhe qytetarëve, nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të matur efektivitetin e iniciativave të tilla.

Shpesh qytetarëve të komunave serbe në veri të Kosovës u mohohet informacioni për mungesë të energjisë elektrike dhe ujit, si dhe për cilësinë e ujit të pijshëm. Gjithashtu, qytetarët janë përgjithësisht të pakënaqur me mënyrën e marrjes së informacionit gjatë situatës emergjente për shkak të krizës Covid-19. Informacioni shpesh ishte i

paqartë, i dykuptimshëm dhe jo në kohë, gjë që çoi në mosbesim më të madh të qytetarëve në institucione.

Fakti që 70% e të anketuarve besojnë se informacioni për mbajtjen e konsultimeve publike nuk arrin në kohë tek qytetarët tregon se edhe nëse institucionet publikojnë informacionin në të gjitha kanalet zyrtare të komunikimit, përsëri nuk është e mjaftueshme për informimin në kohë të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në proceset e vendimmarrjes.

Kur bëhet fjalë për komunikimin e përfaqësuesve të institucioneve në qeveritë lokale, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës me qytetarët, kjo kryesisht varet nga përkatësia politike, njohjet personale, por edhe përkatësia nacionale e qytetarëve. Gjegjësisht, përvojat e qytetarëve të intervistuar tregojnë se qytetarëve të nacionalitetit serb shpesh u mohohet mundësia për të marrë informacione ose shërbime të caktuara nga institucionet sepse nuk njohin dikë që është i punësuar në atë institucion, ose nuk janë politikisht të orientuar ndaj partisë në pushtet. Gjithashtu, ekziston një besim i përgjithshëm se pjesëtarët e komunitetit serb mund të kërkojnë shërbime vetëm nga përfaqësuesit serbë në Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës, dhe se përfaqësuesit shqiptarë nuk kanë detyrim t'u përgjigjen nevojave të qytetarëve nga komuniteti serb.

Koha e krizës është koha kur besimi i qytetarëve në institucione ndjeshëm mund të rritet, por edhe të ulet, varësisht se sa me efikasitet e përballuan institucionet krizën dhe sa arritën të plotësojnë nevojat e qytetarëve. Gjatë pandemisë Covid-19 institucionet e Kosovës dhe Serbisë - kryesisht qeveritë lokale dhe institucionet shëndetësore - treguan aftësinë për të qenë më të hapur ndaj qytetarëve sesa ishte rasti para krizës. Gjatë krizës së Covid-19, përfaqësuesit e qeverive lokale treguan se hapja ndaj qytetarëve dhe medias nuk është e panjohur për ta dhe se mund të jenë shumë të hapur kur duan të jenë. Nga ana tjetër, disa institucione kanë treguar efikasitet të pamjaftueshëm në plotësimin e nevojave të qytetarëve gjatë pandemisë Covid-19. Është e domosdoshme të mësojmë nga gabimet dhe të sigurojmë veprime më efikase të institucioneve në kohë krize dhe më gjerë.

5. Rekomandime

1. Institucionet duhet të sigurojnë dhe të përdorin të gjitha kanalet përkatëse të komunikimit në mënyrë që informacioni të arrijë tek qytetarët

Është e nevojshme që të sigurohet informimi adekuat dhe në kohë i qytetarëve për çështje të rëndësishme. Duke pasur parasysh që qytetarët përdorin burime të ndryshme, informacioni duhet të publikohet në të gjitha kanalet përkatëse të komunikimit, duke përfshirë tabelat e shpalljeve, ueb faqet, mediat tradicionale, mediat sociale dhe portalet, që të gjithë qytetarët të informohen në mënyrë të pranueshme dhe të përballeshme për ta.

2. Të krijohet një sistem efikas për informim të qytetarëve në lidhje me shërbimet të një natyre ekzistenciale dhe situatave emergjente

Në mënyrë që qytetarët të angazhohen në zgjidhjen e problemeve më komplekse në nivelin e komunitetit, së pari duhet të zgjidhen problemet e tyre themelore të një natyre ekzistenciale, të tilla si qasja në ujë të pijshëm dhe energji elektrike dhe informimi për lirinë e lëvizjes dhe gjendjen shëndetësore në komunitetin e tyre.

3. Institucionet duhet të sigurojnë qasje publike në të gjitha dokumentet publike

Nëse dokumentet që me ligj duhet të jenë në dispozicion të publikut bëhen publike, institucionet do të rrisnin transparencën e tyre, do t'u mundësonin qytetarëve që të informohen më mirë për punën e

institucioneve, por gjithashtu do të zvogëlojnë numrin e kërkesave që vijnë nga shoqëria civile, mediat dhe qytetarët për informacione me rëndësi publike.

4. Institucionet duhet të luajnë një rol më aktiv në përfshirjen e qytetarëve në proceset e konsultimeve dhe vendimmarrëse

Transparenca në punën e komunës dhe përfshirja e qytetarëve kërkon një rol më aktiv të institucioneve. Prandaj, është e nevojshme që institucionet të marrin në konsideratë në mënyrë kritike metodat aktuale të informimit dhe thirrjes së qytetarëve për t'u përfshirë në vendimmarrje, dhe të përcaktojnë nëse këto metoda janë efektive apo jo, pra nëse sjellin rezultate. Siç tregon hulumtimi ynë, interesimi i qytetarëve për të marrë pjesë në proceset konsultative është shumë i ulët, kryesisht për shkak të besimit se ata nuk mund të ndikojnë për ndryshim.

Prandaj, institucionet duhet të zhvillojnë mekanizmat ekzistues dhe të prezantojnë metoda shtesë të informimit dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset konsultative dhe vendimmarrëse. Disa nga mënyrat për të arritur këtë mund të jenë: rritja e bashkëpunimit të institucioneve me mediat lokale në mënyrë që qytetarët të informohen më mirë për mbajtjen e seancave dhe konsultimeve publike; sigurimi i transmetimeve të drejtpërdrejta të seancave dhe konsultimeve publike; inkurajimi i qytetarëve për të marrë pjesë në konsultime publike dhe publikimet e rregullta të raporteve nga takime të tilla dhe rezultatet e punës së përbashkët të institucioneve me qytetarët për të zgjidhur problemet në komunitet.

5. Të shfuqizohet politizimi, nepotizmi dhe nacionalizimi i komunikimit dhe bashkëpunimit të institucioneve me qytetarët

Është e nevojshme që institucionet të ndryshojnë sa më shpejt të jetë e mundur qasjen diskriminuese ndaj qytetarëve, e cila varet nga përkatësia e tyre politike ose kombëtare. Institucionet duhet të mundësojnë pjesëmarrje të barabartë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, informim dhe ofrim të barabartë të shërbimeve për qytetarët, pavarësisht nga përkatësia politike, etnike ose çfarëdo përkatësie tjetër.

6. Institucionet duhet të përmirësojnë qeverisjen në kohë krizash për të rritur besimin e qytetarëve në efikasitetin e institucioneve

Është vërejtur që institucionet mund të jenë më të hapura ndaj qytetarëve në kohë krizash. Atë shembull tani ato duhet ta ndjekin dhe ta zbatojnë në të ardhmen edhe në sfera të tjera të punës së tyre, si dhe në institucionet e tjera, në mënyrë që hapja ndaj qytetarëve dhe mediave të vazhdojë pas krizës dhe, si një përjashtim, të bëhet rregull.

Gjithashtu, nevojitet që ligji të mos zbatohet në mënyrë selektive për qytetarët dhe të sigurohet që masat ligjore të zbatohen në mënyrë adekuate, veçanërisht në situata krize. Zbatimi selektiv i masave dhe mos reagimi i institucioneve në situata të rrezikshme zvogëlon besimin e qytetarëve në institucione dhe gatishmërinë e tyre për t'u mbështetur në institucione në kohë krize.

7. Rritja e besimit të qytetarëve në institucione përmes një qasjeje më të hapur ndaj qytetarëve

Në mënyrë që të jenë më të hapur ndaj qytetarëve, institucionet duhet të marrin seriozisht sugjerimet e qytetarëve dhe të punojnë më intensivisht për t'i bërë qytetarët të ndiejnë se zëri i tyre është i rëndësishëm dhe se ai mund të sjellë vërtet ndryshime. Vetëm në këtë mënyrë qytetarët do të rikthejnë besimin tek institucionet dhe do të ngjallin dëshirën për të sjellë ndryshime pozitive në komunitetin e tyre.

Rreth nismës

"Demokracia, hapja dhe perspektiva e komunitetit serb në Kosovë - Open" është një nismë e re e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS), e filluar në vitin 2020. Open zbatohet në bashkëpunim me nëntë organizata të shoqërisë civile që veprojnë në komunitetin serb në Kosovë.

Qëllimi i përgjithshëm i nismës së re është të zhvillojë një hapësirë të hapur dhe dinamike për diskutim brenda komunitetit serb, në mes të komunitetit serb dhe komuniteteve të tjera, si dhe institucioneve në Kosovë.

- Nisma do të adresojë në mënyrë specifike analizën dhe vlerësimin e ndikimit të organizatave civile dhe politike mbi demokracinë dhe hapjen e komunitetit serb në Kosovë.
- Do të analizohen dhe vlerësohen demokracia dhe hapja e institucioneve, politikat publike dhe proceset e rëndësishme ndaj komunitetit serb në Kosovë, si dhe shkalla e hapjes së komunitetit serb ndaj tyre.
- Këto analiza do të ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale dhe perspektivat e komunitetit serb në Kosovë, përderisa në të njëjtën kohë do shërbejnë si bazë për përfaqësim argumentues ndaj qytetarëve, institucioneve të qeverisë lokale dhe qendrore si dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Organizatave me përvojë dhe të dëshmuara të shoqërisë civile, për të arritur qëllime të përgjithshme dhe specifike do të realizojnë tetë (8) analiza sektoriale.

Fushat që partnerët tanë do të analizojnë në vitin 2020 janë:

Mediat Sa ndikojnë mediat në gjuhën serbe në Kosovë në shkallën e hapjes, qasjes dhe pluralizmit të opinioneve dhe temave? Kjo fushë hulumtohet nga **Qendra Mediale** dhe **Bota bardh e zi**.

Shoqëria civile Si kontribuojnë organizatat e shoqërisë civile në hapjen dhe demokracinë e komunitetit serb dhe shoqërisë në Kosovë në përgjithësi? Me këtë temë merret **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Partitë politike Demokracia dhe pluralizmi i partive politike serbe të Kosovës, hapja e tyre për të marrë pjesë në sistemin politik të Kosovës dhe për të kontribuar në avancimin dhe përmirësimin e politikave publike. Në këto çështje do të fokusohet **Iniciativa e re shoqërore** dhe **Qendra Mediale**

Përgjegjësia e institucioneve Përmes monitorimit të kuptohet më mirë pozita e komunitetit serb në Kosovë dhe se sa të hapur janë institucionet ndaj problemeve të serbëve. Analiza realizohet nga **Bota bardh e zi** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Siguria Sa ndikon ndjenja e sigurisë në hapjen e komunitetit serb ndaj institucioneve të sigurisë së Kosovës? Në këtë pyetje kërkon përgjigje **Qendra Humane Mitrovica**.

Ekonomia Sa janë të hapura entitetet ekonomike nga komunitetet me shumicë serbe për integrim në ekonominë e Kosovës? Këtë fushë e analizon **Instituti për Zhvillimin Ekonomik Territorial (InTER)**.

Të drejtat e pakicave Si të arrihet një shoqëri më e hapur duke vënë në pah boshllëqet në zbatim të së drejtave të pakicave? Kjo temë shqyrtohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Qendra për të Drejtat e Komuniteteve të Pakicave**

Procesi i dialogut dhe normalizimi i marrëdhënieve

Kosovë-Serbi - Deri në çfarë mase përfaqësohet dhe cilat janë qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës lidhur me ndikimin dhe të ardhmen e procesit? Kjo analizë realizohet nga **OJQ Aktiv** dhe **Forumi për Zhvillim dhe Bashkëpunim Multietik**.

Në fund të ciklit Open 2020 do të publikohet raporti i konsoliduar „**Karakteristikat e shoqërisë së hapur në komunitetin serb të Kosovës**“ duke i vendosë rezultatet dhe përfundimet e analizave bazë të anëtarëve të iniciativës Open në një kontekst më të gjërë socio-politik të Kosovës.

Iniciativa Open është e përkrahur nga KFOS

